# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-413605**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pas sulmit në Leipzig, Evropa dhe NATO përgatiten për përgjigje të ashpër ndaj Rusisë! Çfarë do të bëjë SHBA? – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/pas-sulmit-ne-leipzig-evropa-dhe-nato-pergatiten-per-pergjigje-te-ashper-ndaj-rusise-cfare-do-te-beje-shba/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 17:47:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 2 shtator 2026, 06:40:59 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `38d3613629f9e3f3d903b85aa0a6ea967bdb8393111f92658187c91c480be874` |
| TEKSTI | `6307b7dc8e019e7169f8a6dcc12ea3eb2f7f9eb6bcac1801e166aa032652413f` |
| PAMJA | `0fc05ed1e8deeb1702a06806573bdc5078259d38468320e05d8ee0b1beffa2ac` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e66a5bc78f6d85a9654b684980349d8dd52d985568e8d54ab52f9b53338596cf` |
| E MËPARSHMJA | `20363e4f83f90f4a90cee21d5b623c33fc4078f7a9af6e9f81392d0a42568843` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e66a5bc78f6d85a9654b684980349d8dd52d985568e8d54ab52f9b53338596cf`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ndërsa Rusia i mohon kategorikisht këto akuza.

Në këtë situatë, Bashkimi Evropian dhe NATO po diskutojnë një përgjigje të përbashkët. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, pritet të zhvillojnë një takim ku në fokus do të jetë forcimi i bashkëpunimit kundër kërcënimeve hibride.

Ndërkohë, ministrat e Jashtëm të vendeve të BE-së dhe NATO-s po shqyrtojnë masa të reja ndaj Rusisë. Gjermania ka kërkuar që në nivel evropian të merren masa ndaj të ashtuquajturës “flotë hije” ruse dhe të vendosen sanksione të tjera.

**Berlini: Nuk është një incident i izoluar**

Ministri gjerman i Brendshëm, Alexander Dobrindt, deklaroi se autoritetet gjermane kanë gjetur elemente që, sipas tyre, lidhin Rusinë me incidentin në Leipzig.

Bëhet fjalë për karakteristikat e dronit, pjesët e përdorura, eksplozivët dhe ngjashmëritë me mënyrën e veprimit të operacioneve të mëparshme ruse në Evropë.

Dobrindt tha se incidenti nuk duhet parë si një ngjarje e veçuar, por si pjesë e një fushate më të gjerë të operacioneve hibride.

“Ne nuk jemi në luftë, por jemi çdo ditë objektiv i luftës hibride”, deklaroi ministri gjerman.

5 shkaktojë tumor”, kirurgu oral: Kur...

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

Sipas autoriteteve gjermane, një dron i pajisur me eksploziv ishte zbuluar më 4 gusht pranë avionëve ukrainas të transportit. Pajisja shpërthyese nuk kishte funksionuar. Gjithashtu, dyshohet se një tjetër dron mund të jetë përplasur me një avion transporti mallrash që ndodhej aty pranë.

Si pjesë e reagimit ndaj situatës, Gjermania ka njoftuar se më 18 shtator do të mbyllë "Shtëpinë e Rusisë" në Berlin dhe Konsullatën Ruse në Bon.

Vendimi është mirëpritur nga institucionet evropiane, partnerët e Berlinit dhe NATO.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, deklaroi se sulmet hibride nuk mund të mbeten pa një përgjigje të qartë.

Edhe presidenti francez, Emmanuel Macron, tha se sulmet e tilla po shtohen në Evropë dhe nuk mund të mbeten pa reagim.

**Moska paralajmëron kundërpërgjigje**

Rusia i ka hedhur poshtë akuzat gjermane.

Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, tha se Berlini po përdor një "justifikim të pabazuar" për të përshkallëzuar marrëdhëniet dypalëshe.

Ajo paralajmëroi gjithashtu se Rusia do të japë një përgjigje ndaj masave të Gjermanisë.

**NATO dhe BE kërkojnë një qëndrim të përbashkët**

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se përpjekjet e Rusisë për të frikësuar vendet evropiane dhe për të dobësuar mbështetjen për Ukrainën do të dështojnë.

Në të njëjtën linjë është shprehur edhe kryeministri grek, Kyriakos Mitsotakis, i cili deklaroi solidaritetin e Greqisë me Gjermaninë.

Mbështetje për Berlinin kanë shprehur edhe Britania e Madhe, Italia, Suedia, Finlanda, Irlanda dhe Ukraina.

Përfaqësuesja e Komisionit Evropian, Paula Pinho, konfirmoi se po përgatitet një takim i ministrave të Jashtëm, me fokus te forcimi i bashkëpunimit mes BE-së dhe NATO-s kundër kërcënimeve hibride.

**Sytë nga Uashingtoni**

Një nga pikëpyetjet kryesore mbetet qëndrimi i Shteteve të Bashkuara.

Ndërsa vendet evropiane dhe NATO po shprehin mbështetje për Gjermaninë dhe kërkojnë një përgjigje të përbashkët ndaj Rusisë, Uashingtoni deri tani nuk ka dhënë një reagim të qartë publik.

Pyetja kryesore është nëse administrata amerikane do të mbështesë publikisht Gjermaninë dhe aleatët evropianë, apo do të përpiqet të ulë tensionet me Moskën.

Një përgjigje për këtë çështje mund të vijë pas takimit mes von der Leyen dhe Rutte dhe diskutimeve të ministrave të Jashtëm.

#Gjermani #Rusi #sulm

**Xhuljana Zhuleku**

Të gjithë artikujt

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

## Vazhdo të lexosh



BOTA

**Tragjedi! Përmbyset anija me pasagjerë,...**

Xhuljana Zhuleku · 5 orë më parë



BOTA

**Zjarr masiv në Kroaci, evakuohen 230...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 19:36



BOTA

**Trump: Lufta me Iranin do të...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 18:51

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

● LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv **Kthehu lart ↑**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.